

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I HISTORISË

REZYME E DISERTACIONIT TË DOKTORATËS

“ZHVILLIMET HISTORIKE DHE POLITIKE NË KOSOVË NË VITET  
1989-1999”

MENTOR: PROF. DR. MUHAMET MALA

KANDIDATI: ARJAN JANOVA

PRISHTINË, 2022

## Rezyme

Teza e doktoratës me titull “Zhvillimet historike dhe politike në Kosovë në vitet 1989-1999” në tërësinë e saj përfshinë gjithë ecurinë e zhvillimit të ngjarjeve me karakter politik dhe historik që janë zhvilluar në Kosovë brenda dekadës së fundit të shek.XX. Duke ndjek aspektin tematik dhe atë kronologjik janë sinkronizuar zhvillimet brenda Kosovës me reagimin e faktorit ndërkombëtar. Për të qenë sa më i strukturuar, këtë punim e kemi ndarë në hyrje dhe në katër kapituj dhe në sythe të shumtë. Kështu, në hyrje, kemi përbledhur në mënyrë telegrafike historinë e Kosovës nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore deri më 1989, kur pushteti jugosllav/serb me dhunë e suprimoi autonominë e saj.

Në kapitullin e parë të këtij punimi kemi trajtuar ngjarjet dramatike që janë zhvilluar në Kosovë gjatë vitit 1989. Në mënyrë të veçant janë trajtuar Greva e Minatorëve (shkurt 1989), suprimimi i autonomisë së Kosovës (23 mars 1989) dhe rezistenca e popullit shqiptar, nëpërmjet demonstratave që janë zhvilluar në Prishtinë dhe në qytetet e tjera të Kosovës, që ishin si formë e kundërshtimit të pushtetit serb. Në këtë kapitull është përfshirë edhe qëndrimi i Tiranës zyrtare, e cila ka reaguar fuqishëm kundër suprimimit të autonomisë së Kosovës dhe përdorimit të dhunës nga forcat policore dhe ushtarake serbe/jugosllave.

Në kapitullin e dytë janë trajtuar çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimet politike në Kosovë në fillim të viteve 90-të. Në mënyrë specifike është trajtuar procesi i krijimit të subjekteve politike, si Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK-1989); Partisë Parlamentare të Kosovës (PPK); Partisë së Prosperitetit Demokratik (PPD); Partisë për Veprim Demokratik (PVD), Partisë Shqiptare Demokristiane të Kosovës (PSHDK) etj. Me krijimin e këtyre subjekteve politike u vunë bazat e pluralizmit politik në Kosovë. Në këtë kapitull gjithashtu është pasqyruar vendosja e masave të dhunshme në Kosovë dhe terrori shtetëror serb mbi popullsinë shqiptare të Kosovës. Në këtë kohë forma më e rënd e akteve të dhunës ishte helmimi i mbi 7 mijë nxënësve dhe studentëve shqiptarë më 1990. Me qëllim të unifikimit të brendshëm shqiptarët me në krye intelektualët e kohës organizuan aksionin për Pajtimin e Gjaqeve. Në këtë kapitull gjerësisht gjeni të trajtuar veprimtarinë politike të partive shqiptare, të cilat ndërmoren veprime tejet me rëndësi si: Deklarata Kushtetuese dhe Kushtetuta e Kaçanikut (Shpallja e

Republikës së Kosovës); zgjedhjet parlamentare-presidenciale dhe krijimi i institucioneve kryesore të vendit, si qeveria, kuvendi etj.

Në kapitullin e tretë kemi trajtuar çështje që ndërlidhen ndërmjet rezistencës paqësore dhe asaj ushtarake. Së pari është pasqyruar filozofia e rezistencës paqësore dhe përpjekjet e saj për të ndërkombëtarizuar çështjen e Kosovës deri tek Marrëveshja e Dejtonit (1990-1995) si dhe marrëveshja arsimore dhe kulturore ndërmjet dr. Ibrahim Rugova dhe Presidentit të Serbisë, Slobodan Millosheviq, që njihet si Marrëveshja e Shën Exhidios (1996). Po ashtu është trajtuar lëvizja studentore, konkretisht demonstratat e 1 dhe 29 tetorit të vitit 1997 dhe dalja publike e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (28 nëntor 1997).

Në kapitullin e katërt, respektivisht të fundit janë trajtuar të fizionuara veprimtaria politike dhe ushtarake e shqiptarëve në Kosovë në vitet e luftës (1998-1999). Me theks të veçant është pasqyruar rezistenca e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ndaj forcave serbe gjatë luftës 1998-1999, si dhe dhuna dhe terrori në shkallën e gjenocidit që ushtria dhe policia serbe kanë kryer ndaj popullsisë shqiptare në Kosovë. Gjithashtu, janë trajtuar çështjet me karakter ndërkombëtar dhe në mënyrë të veçant ndërhyrja e NATO-s në Kosovë, Konferenca e Rambujes dhe Marrëveshja e Kumanovës (1999).

Për të finalizuar këtë punim të doktoratës, janë shfrytëzuar burimet arkivore, që kemi vjelur në arkiva të shumtë në Shqipëri, Kosovë etj, pastaj burimet e botuara si dhe literaturën historiografike, vendore dhe ndërkombëtare, shtypin e kohës etj.

## **Resume**

The doctoral thesis entitled "Historical and political developments in Kosovo in the years 1989-1999" in its entirety includes the entire development of political and historical events that took place in Kosovo within the last decade of the twentieth century. Following the thematic and chronological aspect, the developments within Kosovo are synchronized with the reaction of the international factor. To be as structured as possible, we have divided this paper in the introduction and in four chapters and in numerous loops. Thus, in the introduction, we telegraphically summarize the history of Kosovo from the end of World War II until 1989, when the Yugoslav / Serbian government forcibly abolished its autonomy.

In the first chapter of this paper we have dealt with the dramatic events that took place in Kosovo during 1989. In particular, we have dealt with the Miners' Strike (February 1989), the abolition of Kosovo's autonomy (March 23, 1989) and the resistance of the Albanian people, through demonstrations that took place in Pristina and other cities in Kosovo, which were a form of opposition to the Serbian government. Included in this chapter is the position of official Tirana, which has reacted strongly against the suppression of Kosovo's autonomy and the use of violence by Serbian / Yugoslav police and military forces.

The second chapter deals with issues related to political developments in Kosovo in the early 1990s. The process of creating political entities, such as the Democratic League of Kosovo (LDK-1989), was specifically addressed; Parliamentary Party of Kosovo (PPK); Democratic Prosperity Party (PPD); Party for Democratic Action (PVD), Albanian Christian Democratic Party of Kosovo (PSHDK) etc. With the creation of these political entities, the foundations of political pluralism in Kosovo were laid. This chapter also reflects the imposition of violent measures in Kosovo and Serbian state terror on the Kosovo Albanian population. At this time the most serious form of acts of violence was the poisoning of over 7 thousand Albanian pupils and students in 1990. In order to internal unification, the Albanians, led by the intellectuals of the time, organized the action for the Reconciliation of Bloodshed. In this chapter you will find extensively covered the political activity of Albanian parties, which took very important actions such as: the Constitutional Declaration and the Constitution of Kaçanik (Proclamation of the

Republic of Kosovo); parliamentary-presidential elections and the creation of the main institutions of the country, such as the government, the assembly, etc.

In the third chapter we have dealt with issues related to peaceful and military resistance. First, the philosophy of peaceful resistance and its efforts to internationalize the Kosovo issue until the Dayton Agreement (1990-1995) as well as the educational and cultural agreement between dr. Ibrahim Rugova and the President of Serbia, Slobodan Milosevic, known as the St. Exhadius Agreement (1996). The student movement was also addressed, namely the demonstrations of October 1 and 29, 1997 and the public appearance of the Kosovo Liberation Army (November 28, 1997).

In the fourth chapter, respectively the last one, the political and military activity of the Albanians in Kosovo during the war years (1998-1999) are treated as figures. The resistance of the Kosovo Liberation Army against the Serbian forces during the 1998-1999 war, as well as the violence and terror on the scale of the genocide committed by the Serbian army and police against the Albanian population in Kosovo, were emphasized with special emphasis. Also, issues of international character were addressed, in particular NATO intervention in Kosovo, the Rambouillet Conference and the Kumanovo Agreement (1999).

To finalize this doctoral thesis, archival sources have been used, which we have collected in numerous archives in Albania, Kosovo, etc., then published sources as well as historiographical, local and international literature, the press of the time, etc.